VENDIM
Nr. 192, datë 30.3.2022

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË ZNJ. EDLIRA HAXHIYMERI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, dhe të vendimit nr. 43, datë 19.1.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, për vitin 2022", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të znj. Edlira Haxhiymeri, në masën 1 000 000 (një milion) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj